

Tiranë, më 11.04.2024

NOTË INFORMUESE

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Vërejtje konfidenciale”, për magistraten Sh.M.,

Hetimi disiplinor ndaj magistrates Sh.M., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka nisur me nismë të ankuesit, Prokurorit të Përgjithshëm, mbi ankesën e një punonjësi të prokurorisë Shkodër, për shkelje të rëndë nga ana e magistrates e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, lidhet me konstatimin gjatë muajit Dhjetor të vitit 2020, të disa fakteve që lidhen me shkelje të rregullave të sjelljes me personelin e administratës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rezulton se:

- Magjistratja ka shkelur rregullat e sjelljes me personelin e administratës së prokurorisë, pikërisht ftuesin e këtij institucionit, në shkelje të parimit të respektimit të rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale. Këto shkelje të konstatuara nuk lidhen me veprimtarinë e saj profesionale dhe mund të jenë të rëndësishme vetëm me qëllim vlerësimin etik dhe profesional të saj, por janë të natyrës që magjistratja duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore.
- Rezulton se nga sjellja dhe veprimet e magistrates Sh. M., megjithëse veprimet e saj janë kryer me dashje, pasojat e shkeljes së kryer janë pakësuar dhe zhdukur nga fakti se veprimet disiplinore e ligjore reciproke janë “Pushuar” dhe “Mosfilluar”, duke mos krijuar pasoja ligjore për palët, ndërsa më pas marrëdhëniet janë normalizuar.
- Sjellja e prokurorëve në kontekstin profesional është shumë e rëndësishme. Referuar parimeve të Bangalores, cenimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.
- Qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklaramit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit. Masa përmbush edhe dy qëllime parandaluese: *parandalimin e posaçëm*, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe *parandalimin e përgjithshëm*, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

Nga hetimi disiplinor konkludohet se shkeljet e kryera nga magjistratja Sh. M. marrin karakter të lehtë, duke pasur parasysh edhe mungesën reale të pasojës dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon KLP-së masën disiplinore “Vërejtje konfidenciale”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 2, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.